



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, parashtron këtë:

PROPOZIM

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 3 dhe 4 Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2023, të miratojë këtë

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARES SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI –KKSB-së

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarit të KKSBS-së

Me këtë Vendim, **zëvendësohet** anëtarja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi **Gjyste Dabaj**, ish zyrtare për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore në Komunën e Lipjanit, në numrin rendor 13 të nenit 1 të Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.020-6049 të datës 31.01.2022, për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi –KKSB, për arsye të pensionimit dhe në vend të saj **caktohet Hasan Luma**, Zyrtar për barazi gjinore në Komunën e Lipjanit .

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKSBS-në është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale

për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-6049 i datës 31.01.2022.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 3 dhe 4 Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Zëvendësimi i anëtares së cekur numrin rendor 13, bëhet përshkak se e njëjta është pensionuar ndërsa propozohet emërimi i zyrtarit të lartëcekur me qëllim të plotësimit të pozicionit të kërkuar si anëtar i KKSB-së konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi .

Nga arsyet e lartëcekura dhe në pajtim me dispozitat Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në Bashkësi dhe Statutit të Komunës Kryetari i Komunës kërkon nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi

1Nr. 020/04-18350
Lipjan, më 13.04.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

